



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 8 datë 30/01/1998

**“PER
CELJE FONDESH PER BLERJE PAJISJE ZYRASH E
AUTOMJETESH”.**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, i mbledhur sot me dt.30.01.1998, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve të Brendëshme, mbështetur në ligjin Nr.7776, dt.22.12.1993 “Për Buxhetin Lokal” në Republikën e Shqipërisë,

V E N D O S I

1. Të miratojë shumën prej 15.000.000 lekësh për blerjen e pajisjeve të zyrave të Bashkisë dhe të Njësive Administrative (tavolina, karrike, kasaforta, etazhere).
2. Të miratojë shumën prej 6.000.000 lekësh për blerjen e automjeteve për nevojat e Bashkisë dhe Njësive Administrative.
3. Të paraqitet një preventiv analitik me zëra për përdorimin e fondeve që u miratuan prej 21.000.000 lekë, të ndara në 3-mujor për vitin 1998.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve të Brendëshme.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI